



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:285613

Datë: 31.05.2021

Numri i dokumentit: 01832529

AA.nr.381/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS -Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi, kryetar, Delushe Halimi dhe Gani Avdiu, anëtarë, me zyrtarin ligjor Visar Gashi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “F...”, sh.p.k me seli në, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike vlerësim i mallit doganor, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2574/2019, të datës 03.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.05.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit “F...”, sh.p.k me seli në, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizion Fiskal, A.nr.2574/2019, i datës 03.02.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizion Fiskal, A.nr.2574/2019, të datës 03.02.2021, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit “F...”, nga Drenasi, ndërsa mbetet në fuqi aktvendimi nr.01.3.2.2/470/16 i datës 23.09.2019, i Doganës së Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, avokat K.B., nga Prishtina, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, ashtu që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit, ndërsa të anulohet aktvendimi i kontestuar i të paditurës nr.01.3.2.2/470/16 i datës 23.09.2019, dhe të detyrohet e paditura që paditësit t’ia kthejë shumën prej 14.544.11 €, të paguara më tepër në emër të detyrimeve të importit për shkak të rivlerësimit të mallrave të deklaruara për doganim me DUD-in, kontestues R-21848 të datës 26.05.2016, me kamatë ligjore në shkallë prej 8 %

nga data e pagesës, e deri në kthimin e plotë, ose aktgjykimi i ankimuar të prishet, dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/470/16 të datës 23.09.2019 të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedurë “F...”, sh.p.k me seli në Komoran, Drenas, me numër fiskal për rishqyrtimin e Deklaratës Unike Doganore R-21848 të datës 26.05.2016 me të cilat vendimit i është kontestuar vlera e mallit lëndor të deklaruar për zhdoganim në Zyrën e Brendshme Doganore në Prishtinë.

Paditësi i pa kënaqur me aktvendimin e lartcekur të Doganës së Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 30.10.2019, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/470/16 të datës 23.09.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar, duke lënë në fuqi aktvendimin e lartcekur të Doganës së Kosovës në Prishtinë. Me arsyetim se gjykata nuk i aprovoi pretendimet e paditësit, për arsye se për të vërtetuar se paditësi ka paguar vlerën reale të mallit lëndor, duhet që pretendimet të bazohen në argumente të bazuara. Ndërsa nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata ka konstatuar se paditësi nuk ka prezantuar dokumentacion të kompletuar për të dëshmuar se vlera e deklaruar paraqet vlerën reale të transaksionit në kuptim të nenit 33 të KDAK-së. Andaj, në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata ka konstatuar se aktvendimi nr.01.3.2.2/470/16 i datës 23.09.2019, i Doganës së Kosovës në Prishtinë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj

ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe KDAK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike, pasi që nuk ka marrë fare për bazë faktin se malli lëndor ka qenë i përdorur dhe me defekte, dhe kjo ka ndikuar që malli të ketë një çmim më të lirë. Gjendja faktike e mallit përshkruhet në nenin 3 të kontratës, dhe Dogana nuk ka konstatuar gjendje tjetër faktike të tij me rastin e kontrollit, ndërsa gjykata fare nuk ka marrë për bazë këtë pretendim të paditësit, dhe nuk e ka arsyetuar refuzimin e tij. Pra, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike, pasi që ka mbështet arsyetimin në dokumente që nuk janë lexuar si prova, siç mund të shihet në procesverbal, dhe se DUD-at referues në të cilët mbështetet vendimi i gjykatës, përmbajnë të dhëna për mallra me marka tregtare tjera nga ato të paditësit, me eksportues të tjerë dhe prodhues të tjerë, andaj, nuk mund të jetë krahasim objektiv, shtuar kësaj faktin se mallrat e paditësit kanë qenë me defekte. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të KDAK-së, për faktin se nuk është zbatuar në mënyrë adekuate dispozita ligjore nga neni 33 i tij, i cili parasheh se mallrat që importohen në Kosovë obligohen që taksat doganore t'i paguajnë në bazë të vlerës së transaksionit, në rastet kur importuesi posedon dokument të malit në bazë të së cilave mund të vërtetohet kjo vlerë. Gjithashtu, ekziston shkelja e dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 për zbatimin e KDAK-së, përkatësisht nenit 123 të tij, pasi që paditësi me rastin e importimit të mallrave, pastaj në procedurë të ankesës dhe të konfliktit administrativ i ka bashkangjitur edhe dokumentet e parapara me të, ndërsa gjykata ka konstatuar se dokumentacioni i paditësit është i pa mjaftueshëm, duke mos theksuar se çka mungon. Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara, ngase gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ nuk ka mundur që të vërtetojë një tjetër gjendje faktike nga ajo që ka vërtetuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për faktin se nuk ka qenë e mundur që të vërtetohet se vlera e deklaruar për zhdoganim është vlerë reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë. Ndërsa paditësi me padinë e tij dhe në seancën gjyqësore nuk ka dhënë shpjegime të mjaftueshme lidhur me çmimin e mallit lëndor të ofruar nga eksportuesi F.....- Gjermani, se ky çmim i mallit lëndor nuk ka ndikuar në lidhje. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë me të drejtë nuk e ka kontestuar faktin se paditësi ka paraqitur dokumentacionin përcjellës së mallit lëndor për të dëshmuar vlerën reale të tij, si fatura e mallit lëndor, kontratën e shitjes, transferin bankar, deklaratën e shtetit eksportues, mirëpo përshkrimi i pagesës bankare të datës 23.05.2016 P....., nuk jep shpjegime të qarta se pagesa është bërë në tërësi për tërë sasinë e mallit lëndor, pasi që vlera faturale në shumën prej 5,496.00 €, ka të bëjë vetëm për një produkt të mallit: një samsung multi xpress 6545nx 150 copë, ndërsa dy produkte tjera lexmark x463, 100 copë, dhe lexmark T652dn, 124 copë, nuk është cekur ndonjë vlerë. Prandaj, nga provat e administruara gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka pranuar konstatimet në arsyetimin e vendimit kontestues të paditurës se lidhja familjare e vërtetuar edhe gjatë procedurës së konfliktit administrativ, ka ndikuar në çmimin e kontraktuar të mallit lëndor, pasi që pronari i eksportuesit me importuesin janë në lidhje familjare, fakte që dëshmohen me kontratën e shitblerjes të nënshkruar nga personat përgjegjës, dhe pranimi i kësaj lidhje nga komunikimi me paditësin. Andaj, gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se e paditura drejtë i'u ka referuar dispozitës së nenit 33 par.2 pika a) të KDAK-së, e po ashtu duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e LKA, Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, si dhe Kodit nr.03/L-109 Doganor dhe të Akcizave në Kosovë.

Prandaj, propozimi i përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, me parashtresën për plotësimin e ankesës së gjykata e shkallës së dytë në kuptim të nenit 81.G të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, për shqyrtimin e kësaj çështje administrative-juridike, në seancën e kolegjit duhet që të thërras palët ndërgjyqëse, kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, sepse gjendja e vërtetuar faktike nga ana e gjykatës të shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Kurse, pretendimet tjera ankimore të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktgjykimit të ankimuar konsiderojmë se ka dhënë një vendim kontradiktor, sepse dispozitivi është në kundërtënie me arsyetimin, është i pakuptueshëm dhe nuk janë analizuar në mënyrë të duhur faktet dhe provat vendimtare, si dhe nuk është dhënë arsyetim i mjaftueshëm për mospranimin e pretendimeve të paditësit për faktet vendimtare. Ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë pa bazuar, dhe si të tilla janë pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike, nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Sepse sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Prandaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji material në dëm të tyre, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.381/2021, me datë 28.05.2021

Zyrtari Ligjor
Visar Gashi

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi